

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Gjykatës Speciale/ Kurti takim me kreun e PDK-së, Hamza
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/vendimi-i-gjykates-speciale-kurti-takim-me-kreun-e-pdk-se-hamza-i474478
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:04:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:51:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d0a654f98a67b410681ceae1d3c81d83f07ef2d30e22e6a839f242da6258630
TEKSTI	b30d22a022c576b9880c96a76cbfea62bf19ff884671ea5dc80b994d6c9e3659
PAMJA	308da8d582ca223ccfe57c7395be1fdf76a58a765639d2ec69edbf436935cf0a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8428ebaab86d212a1412230be482c449bc7c8434dd578a05b1cb8609fe91595d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8428ebaab86d212a1412230be482c449bc7c8434dd578a05b1cb8609fe91595d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

18:01 Aktualitet

Nënkryetari i PD-së Belind Këlliçi gjatë fjalës së tij në ...

Vendimi i Gjykatës Speciale/ Kurti takim me kreun e PDK-së, Hamza



17 Shtator 2026, 17:51, Kosova & Bota CNA



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar me udhëheqësin e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, me të cilin ka biseduar për mënyrat që duhen ndjekur "për të korrigjuar" aktgjykimin dënues ndaj katër ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të shpallur nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Më 16 shtator, Hashim Thaçi, ish-president i Kosovës, dhe Jakup Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, u dënuan me nga 25 vjet burgim. Kadri Veseli, po ashtu ish-kryetar i Kuvendit, u dënua me 18 vjet burgim, ndërsa Rexhep Selimi, ish-deputet, me 13 vjet.

"Duke e vlerësuar aktgjykimin të padrejtë, të rëndë dhe me pasoja të gjera, kryeministri Kurti theksoi se ai duhet ndryshuar pozitivisht në shkallën e apelit. Kurti e Hamza ndanë mendimet dhe përshtypjet e tyre si dhe diskutuan se cilat do të ishin rrugët e mënyrat që duhet ndjekur përpara për të korrigjuar vendimin e djeshëm", u tha në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Ekipet mbrojtëse të katërshes së UÇK-së kanë paralajmëruar se do ta apelojnë vendimin e shkallës së parë.

Takimi mes Kurtit dhe Hamzës vjen disa orë pasi strukturat udhëheqëse të PDK-së u takuan dhe Hamza tha më pas për mediat se beson se do të takohet me të gjithë udhëheqësit e subjekteve politike, duke argumentuar se aktgjykimi i shpallur nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë nuk është një çështje "që i takon vetëm një subjekti politik".

"Besoj në bashkëpunimin mes partive politike, dhe në arritjen e konsensusit të nevojshëm", deklaroi ai më herët gjatë 17 shtatorit.

Hamza u pyet edhe për mundësinë e ndonjë nisme për zhbërjen e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë, që njihen si Gjykata Speciale.

"PDK-ja i ka nënshkrimet e gatshme, varësisht prej nevojave ne do të procedojmë. Nuk po flasim për zhbërjen e Gjykatës Speciale, po flasim për përshtatje me një situatë të re. Nuk po i ikim obligimit që e kemi marrë që Gjykata t'i hetojë, t'i prezantojë e faktojë të gjitha gjetjet e raportit të Dick Martyt për çka edhe është krijuar Gjykata", deklaroi ai.


Hamza ka deklaruar pas vendimit të Gjykatës Speciale se PDK-ja do të përdorë të gjitha mjetet e nevojshme ligjore dhe demokratike për të kundërshtuar vendimin ndaj katërshes së UÇK-së.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën fajtorë për katër akuzat për krime lufte: arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.

Ata u liruan nga gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit.

Gjykata Speciale u themelua më 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është gjykatë brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar në Holandë.

Ajo heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000./REL





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Meta urdhërohet të heqë video-t e rreme me IA

Kryeministri jep dorëheqjen pas humbjes në zgjedhje

Tromp: Specialja u krijua për ta kënaqur Serbinë, jo për drejtësi

Afatet e paraburgimit/ Apeli i GJKKO-së rrëzon kërkesën e Metës

Protesta kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së/ Një pjesë e objektit të EULEX-it përfshihet nga zjarri

Kongresi amerikan e miraton ligjin për sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Rusisë

Von der Leyen: Europa ka nevojë për mekanizëm të ri sigurie ndaj kërcënimeve hibride

Trump takohet javën e ardhshme me udhëheqësit e vendeve të Gjirit Persik

Sulmet ruse plagosin disa persona në Kiev dhe Odesa

Pak para asamblesë së OKB-së/ SHBA-të refuzojnë t'i japin vizë presidentit të Autoritetit Palestinez

Propozimi për anëtarësimin e Kanadasë/ Trump kërcënon BE-në me tarifa të larta

Shpërthimi i fruthit në Bangladesh/ Mbi 1000 fëmijë humbin jetën

"Gjykata në Hagë, politike"/ Ministri i Kurtit: Në emër të popullit, ish-krerët e UÇK janë çlirimtarë

Gjigandi farmaceutik do të përdorë Claude të Anthropic për të zbuluar barna me anë të inteligjencës artificiale

"Ne e dimë historinë"/ Djali i Hashim Thaçit: Ashtu si babi sot, do të vazhdojmë përpara me kokën lart

Arabia Saudite akuzon Huthit për sulmin e "vijës së kuqe" në Mekë

AKB: Pas vendimit në Hagë, Kosova rrezikon kosto ekonomike dhe besimin e investitorëve

Rezerva Federale rrit normat e interesit për herë të parë që nga viti 2023

Gjyqi në Hagë/ Gjenerali i NATO-s: Nuk kam parë asnjë dëshmi që të justifikojë vendimin


Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Reagojnë Rita Ora dhe Dua Lipa

[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

17:17 Opinione Elvi FUNDO

Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit

15:08 Opinione Ardi Stefa

Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë

[Lifestyle](#)

07:38 Lifestyle

Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

20:40 Lifestyle

Si të çmoheni shpejtë dhe a njohja të qazures? Ja një truk i thjeshtë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.